ADRION Shpk

# Shenime per pasqyrat financiare per vitin mbyllur me 31 Dhjetor 2019

## 1. Te pergjithshme

Shoqeria "ADRION" sh.p.k eshte krijuar si shoqeri me pergjegjesi të kufizuar me Vendim të Gjykates se Rrethit Tirane Nr. 7467 date 05.12.1994. Themelues te shoqerise jane ortaket Christopher Hadzopoulos dhe Teodor Misha. Veprimtaria e saj rregullohet sipas dispozitave perkatese të Ligjit 9901 date 14.04.2016, "Për tregtaret e shoqerite tregtare" si dhe nga statuti dhe legjislacioni shqiptar ne fuqi.

Ne 31 Dhjetor 2019, struktura e pjesemarrjes ne kapitalin themeltar dhe perqindja qe zoterohet nga ortaket eshte si vijon:

1. Teodor Misha ........................................................80,000 ALL ose 80%
2. Christoforos Chatzopoulos ........................................20,000 ALL ose 20%

Objekti i veprimtarise:
Ne fushen e importit – eksportit te gazetave, revistave dhe librave te huaj si dhe tregetimin e tyre.

Ne daten 31 Dhjetor 2019 Shoqeria " ADRION" shpk kishte43 (2018: 41) punonjes.

## II. Baza e Pregatitjes

### (a) Parimi i perputhshmerise

Paqyrat financiare jane pregatitur ne perputhje me Standartet Kombetare te Kontabilitetit (SNK) sipas kerkesave te Ligjit Nr. 9228 date 29.04.2016 "Per Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare".

Bilanci paraqet informacion mbi pozicionin financiar te shoqerise ne fund te dates 31.12.2019. Ai perbehet nga tre pjese kryesore, aktivet qe kontrollohen nga njesia shoqeria, pasivet qe duhet te permbushe shoqeria dhe nga kapitalet e pronarve te shoqerise. Nje pershkrim i detajuar per politikat kontablie te ndjekura jepet ne Shenimet perkatese.

### (b) Parimi i Matshmerise

Keto pasqyra financiare jane pregatitur mbi bazen e kostos historike, pervec vlerave monetare qe jane sipas vleres se drejte.

### (c) Monedha funksionale

Keto pasqyra financiare jane paraqitur ne Leke qe eshte dhe monedha funksionale e shoqerise.

### (d) Menyrat e vleresimit dhe gjykimit

Pregatitja e pasqyrave financiare kerkon qe menaxhimi te beje gjykime, vleresime dhe supozime qe ndikojne ne zbatimin e politikave dhe ne shumat e raportuara te aktiveve, detyrimeve, te ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultatet aktuale mund te ndryshojne nga keto vleresime. Vleresimet dhe supozimet e nenkuptuara jane rishikuar ne vazhdimesi. Rishikimet e vleresimeve kontabel njihen ne periudhen ne te cilen behet rishikimi dhe jo ne retrospektive. Ne vecanti, informacioni mbi fusha te rendesishme te pasigurise se vleresimit dhe gjykimit kritik ne perputhje me politikat kontabel qe kane efektet me domethenese ne shumat e njohura ne pasqyrat financiare jane pershkruar ne Shenimin 5.

## III. Permbledhje e politikave kontabel

Politikat kontable te dhena me poshte jane aplikuar qe nga 1.01.2016 dhe jane ne perputhje me parimet baze te pershkruara ne Ligjin ne. 9228 " Per kontabilitetin dhe pasqyrat financiare" si dhe Standartet Kombetare te Kontabilitetit te miratuara nga Keshilli Kombetar i Kontabilitetit.

### (a) Transaksionet ne monedhe te huaja

Transaksionet ne monedhe te huaj jane kembyer me kursin e kembimit te dates se transaksionit. Aktivet dhe detyrimet monetare ne monedhe te huaj jane kthyer me kursin e kembimit ne mbyllje te vitit. Diferencat nga kursi i kembimit jane te njohura ne pasqyren e fitimit ne Rezultate neto te kembimit. Aktivet dhe detyrimet jo monetare ne monedhe te huaj qe jane paraqitur me kosto hisorike jane kthyer me kursin e kembimit te dates se transaksionit. Aktivet dhe detyrimet jo monetare ne monedhe te huaj qe jane paraqitur me vlere tregu jane kthyer me kursin e dates kur eshte percaktuar vlera e tregut.

Normat e kembimit (Lek per monedhe te huaj) per monedhat kryesore me 31 Dhjetor 2017 dhe 31 Dhjetor 2016 jane si me poshte:

| | 31 Dhjetor 2019 | 31 Dhjetor 2018 |
|---|---|---|
| 1 EUR | 121.77 | 123.42 |
| 1 USD | 108.64 | 107.82 |
| 1 GBP | 143.00 | 137.42 |
| 1 CHF | 112.30 | 109.6 |

### (b) Instrumentat financiare

Mjetet monetare ne arke dhe ne banke perfshijne tepericat ne para. Overdraftet e ripagueshme me kerkese dhe qe formojne pjese integrale ne administrimin e mjeteve monetare te shoqerise, per qellime te pasqyres se fluksit te arkes. Regjistrimi kontabel per te ardhurat financiare dhe shpenzimet eshte sqaruar ne shenimin III.j.k.

Instrumentat financiare per shoqeri te lidhura.

Shoqeri te lidhura jane ato entitete ne te cilat ne kemi influence sinjifikative, por nuk kemi kontoll, mbi politikat financiare dhe operative.

Kapitali aksioner

Kapitali i aksionereve te Shoqerise njihet me vlere nominale.

Dividentet

Dividentet njihen si detyrim per periudhen ne te cilen ata deklarohen.

Te tjera

Aktive te tjera financiare maten me koston e amortizuar duke perdorur metoden e interesit efektiv dhe duke zbritur humbjet nga zhvleresimi.

### III. Permbledhje e politikave kontabel (vazhdim)

### (c) Aktive afatgjata materiale

Njohja dhe matja
Zerat e aktiveve afatgjata materiale paraqiten me koston e tyre historike shoqeria nuk ka rivleresuar akivet afatgjata materiale
Kostot perfshine shpenzimet qe jane bere direkt te atribueshme per blerjen e aktivit. Kostot e aktivit te ndertuar nga vete shoqeria, perfshijne koston materiale dhe te fuqise puntore, si dhe ndonje kosto tjeter qe lidhet direkt me venien e aktivit ne kushte pune, si dhe kostot e cmontimit dhe te zhvendosjes dhe te magazinimit te tyre ne vendodhjen perkatese. Kosto e financimit ne lidhje me blerjen apo ndertimin e aktiveve specifike njihet ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve me te ndodhur.

Kur pjese te nje zeri te aktiveve afatgjata materiale kane jete te dobishme te ndryshme, ato kontabilizohen si zera te ndryshem (komponente kryesor) te aktiveve afatgjata materiale.

Fitimet dhe humbjet nga shitja e nje zeri te aktiveve afatgjata materiale vendosen duke krahasuar te hyrat monetare nga shitja me vleren e mbartur te aktiveve materiale te trupezuara , dhe njihen neto brenda zerit “ te ardhura te tjera “ ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve. Kur aktivet e rivleresuara shiten, sasite e perfshira ne rezerven se rivleresimit transferohen ne fitimin e mbajtur, ndersa deficiti i rivleresimit njihet ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimit te periudhes.

(ii)Kostot e mepasshme
Kostoja e zevendesimit te nje pjese te aktiveve afatgjata materiale njihen ne vleren mbartur te nje zeri nese eshte e mundur qe perfitime ekonomike te ardhshme te trupezuara ne pjese do te qarkullojne ne Shoqeri dhe kostoja e saj mund te vleresohet besueshem . Vlera e mbartur e pjeseve te zevendesuara nuk njihet.
Kostoja e sherbimeve ditore te aktiveve afatgjata materiale njihet ne pasqyren e te ardhurave e shpenzimeve ku ndodhin.

(ci) Amortizimi

Amortizimi njihet ne pasqyren e te ardhurave e shpenzimeve me baze lineare per ndertesat dhe instalime te pergjithshme mbi jeten e dobishme te vleresuar te cdo pjese te nje zeri te aktiveve materiale te trupezuara dhe me metoden zbritse per makinerite dhe paisjet, mjetet e transportit, paisjet e zyres dhe kompjuterike, dhe aktivet e tjera me nje norme amortizimi sic shpjeguar me poshte. Toka dhe punimet ne process nuk amortizohen.

Me poshte jane perafersime te jetes se dobishme:

| | 2019 | 2018 |
|---|---|---|
| Metoda zbritese | ( norma ) | ( norma) |
| • Ndertesa | 5% p.v | 5%p.v |
| • Instalime te pergjithshme | 5%p.v | 5%p.v |
| Metoda zbritese | (norma) | (norma) |
| • Instalime teknike , makineri dhe pajisje | 20% p.v | 20% p.v |
| • Mjete transporti | 20% p.v | 20% p.v |
| • Kompjutera dhe pajisje zyre-furnitura | 20% p.v | 10% p.v |
| • Kompjutera dhe pajisje zyre-kompjutera | 25% p.v | 25% p.v |
| • Aktive te tjera | 20% p.v | 20% p.v |

## III. Permbledhje e politikave kontabel (vazhdim)

( e ) Inventari

Inventari vleresohet me vleren me te ulet midis kostos dhe vleres se realizueshme. Kostoja e inventarit bazohet ne koston mesatare te ponderuar, dhe perfshin shpenzime te ndodhura gjate blerjes se inventarit, kosto prodhimi ose kosto transformimi dhe kosto te tjera te lidhura me sjelljen e tyre ne kushtet dhe pozicionin ekzistues. (Ne rastin e inventarit te prodhuar dhe prodhimit ne process, kosto perfshin nje pjese te caktuar shpenzimeve te pergjithshme te prodhimit bazuar ne kapacitetin normal te aktivitetit nuk ka.)

Vlera e realizueshme neto eshte cmimi i shitjes i vleresuar ne rrjedhen normale te biznesit, minus kostot e finalizimit dhe shpenzimet e shitjes.

( g ) Perfitimet e punonjesve

( i ) Kontributet e detyrueshme te sigurimeve shoqerore

Shoqeria paguan vetem kontribute te detyrueshme te sigurimeve shoqerore qe u sigurojne perfitime pensione punonjesve pas daljes ne pension. Qeveria shqiptare eshte pergjegjese per sigurimin e kufirit minimal te caktuar me ligj per pensionet ne Shqiperi sipas nje plani te percaktuar kontributesh pensioni. Kontributet e Shoqerise ne planin e perfitimit te pensioneve ngarkohen ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve atehere kur ndodhin.

( ii ) Leje vjetore e paguar

Shoqeria njeh si detyrim shumen e paskontuar te kostove te parashikuara lidhur me lejen vjetore qe pritet te paguhet ne kembim te sherbimit te punonjesve per periudhen e perfunduar.

( j ) Njohja e te ardhurave

( jj ) Mallrat e shitur

Te ardhurat nga shitja e mallrave jane matur me vleren e drejte te pagesave te arketuara ose te arketueshme , pakesuar me tatimet dhe taksat mbi shitjet dhe mbi fitimin (akcizat, taksat e rruges, dhe te tjera te ngjashme). Te ardhurat njihen kur rreziqet dhe perfitimet nga pronesia jane transferuar te blerese, arketimi i pagesave eshte i mundshem, kostot e lidhura dhe kthimi i mundshem i mallrave mund te parashikohen ne menyre te besueshme, nuk ka pjesmarrje te metejshme ne menaxhimin e mallrave dhe shuma e te ardhurave mund te matet ne menyre te besueshme. Transferimet e rreziqeve dhe te perfitimeve ndryshojne ne varesi te kushteve specifike te kontrates se shitjes.

( jjj ) Sherbimet
Te ardhurat nga sherbimet e kryer jane njohur si fitim ose humbje ne perpjestim me fazen e perfundimit te transaksionit ne daten e raportimit. Faza e perfundimit vleresohet duke iu referuar inspektimeve te punes se kryer.

( jjjj ) Te ardhurat nga qeraja

Te ardhurat nga qeraja mbi pronat per investime njihen si fitime ose humbje ne menyre lineare pergjate afatit te qerase. Incentivat e dhena gjate afatit te qerase jane njohur si nje pjese integrale e te ardhurave totale nga qeraja, pergjate afatit te qerase.

**III. Permbledhje e politikave kontabel (vazhdim)**

( k ) Shpenzimet operative

Shpenzimet operative njihen atehere kur ndodhin.

( kk ) Pagesat e qerase

Pagesat minimale te qerase bere per qerate financiare jane ndare ndermjet shpenzimit financiar dhe paksimit te detyrimit ekzistues. Shpenzimi financiar eshte shperndare ne cdo periudhe pergjate afatit te qerase ne menyre qe te paraqese nje norme te pandryshueshme interesi mbi tepricen e mbetur te detyrimit. Pagesat e mundshme te qerase kontabilizohen duke shqyrtuar pagesat minimale te qerase pergjate afatit te mbetur te qerase, pasi te konfirmohet korrigjimi i qerase.

( kkk) Te ardhurat dhe shpenzimet financiare

Te ardhurat financiare perfshijne te ardhurat nga interesi i balancave me bankat dhe te ardhurat nga kembimi valuator qe njihen si fitime ose humbje. Te ardhurat nga interesi njihen mbi baze rrjedhese, duke perdorur metoden e interesit efektiv.

Shpenzimet financiare perfshijne humbjet nga kembimi valutor.

( l ) Tatimi mbi fitimin

Tatimi mbi fitimin ose humbjen per vitin perfshin tatimin aktual dhe ate te shtyre. Tatimi mbi fitimin eshte njohur ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve pervec pjeses qe lidhet me zera te njohur drejtperdrejt ne kapital, rast ne te cilin ai njihet ne kapital.

Tatimi aktual eshte tatimi i pagueshem i pritshem mbi te ardhurat e tatueshme te vitit, duke perdorur normat tatimore ne fuqi ne daten e hartimit te bilancit, dhe cdo rregullim te tatimit te pagueshem ne lidhje me vitet e kaluara .

Tatimi i shtyre llogaritet duke perdorur metoden e detyrimeve te bilancit, duke siguruar diferencat e perkohshme midis vleres se mbartur te aktiveve dhe detyrimeve per qelime te raportimit financiar dhe shumave te perdorura per qellime tatimi. Shuma e llogaritur e tatimit te shtyre bazohet ne menyren e pritur te realizimit ose shlyerjes se vleres se mbetur te aktiveve dhe detyrimeve, duke perdorur normat tatimore ne fuqi ne daten e pergatitjes se bilancit.

Nje aktiv i shtyre tatimor njihet vetem ne qofte se ekziston mundesia e realizimit te fitimeve te tatueshem perkundrejt te cileve aktivi mund te perdoret. Aktivet tatimore te shtyre reduktohen ne momentin qe nuk eshte me e mundur qe perfitimet tatimore te lidhura me to te realizohen.

( m ) Standarte te reja dhe interpretime qe kane filluar te zbatohen

Ne daten e autorizimit te ketyre pasqyrave financiare, nuk ka pasur ndryshime ne Standartet Kombetare te Kontabilitetit, ato jane zbatuar plotesisht gjate pergatitjes se ketyre pasqyrave financiare

## 2. Aktive Monetare

Me 31 Dhjetor 2019 dhe 31 Dhjetor 2018gjendja e aktiveve monetare paraqitet si me poshte:

| | **31/12/2019** | **31/12/2018** |
|---|---|---|
| Gjendje ne arke (Kesh ne dore) | 709,218 | 667,149 |
| Gjendje ne Banka (Kesh ne Banka.) | 18,913,115 | 21,695,824 |
| | | |
| **Total** | **19,622,333** | **22,362,973** |

Kesh dhe ekuivalente te tij, perfshire ne shenimin e mesiperm, te analizuara ne monedhat qe vijojne:

| | **31/12/2019** | **31/12/2018** |
|---|---|---|
| **Monedha lokale** | 5,214,572 | 5,087,962 |
| **EURO** | 8,472,899 | 9,706,853 |
| **US DOLLAR** | 235,481 | 99,767 |
| **Paund britanik** | 5,675,820 | 7,457,457 |
| **Franga zvicerian e** | 23,561 | 10,934 |
| **Total** | **19,622,333** | **22,362,973** |

Shoqeria operon ne disa banka, mjetet monetare ne valute te huaj jane vleresuar me kusin fiks te Bankes se Shqiperise te dates 31.12.2019.

## 3. Nga shfrytezimi

Me 31 Dhjetor 2019 dhe 31 Dhjetor 2018 Kerkesat e Arketueshme paraqiten si me poshte:

| | **31/12/2019** | **31/12/2018** |
|---|---|---|
| Kliente te arketueshem | 6,355,122 | 6,489,696 |
| Kliene me probleme | 958,456 | 958,456 |
| Kliente per abonime | 1,632,340 | 2,285,356 |
| **TOTALI** | **8,945,918** | **9,733,508** |
| Zhvlersim i te drejtave (Klienteve) | | |
| **TOTALI NETO** | **8,945,918** | **9,733,508** |

Klientet per shitje perbehen nga kliente te vitit 2019 qe jane te arketueshem si dhe nga kliente me probleme ne vleren 958,456 te mbartur , si dhe klientet per abonime 1 632 340 leke.

## 4. Kerkesa te tjera

Me 31 Dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018 Kerkesat e tjera te Arketueshme paraqiten si me poshte:

| | 30/12/2019 | 31/12/2018 |
|---|---|---|
| Furnitore per mallra, produkte dhe sherbime (teprica debitore) | | 938,616 |
| Parapagime te dhena | 21,834 | |
| Paradhenie per punonjesit | 131,967 | 180,523 |
| Sigurimet shoqerore per raportet | | |
| Tatim mbi fitimin (teprica debitore) | | 855,667 |
| Shteti -TVSH per t'u marre | | |
| **Subtotal** | **153,801** | |
| Zhvleresim i te tjera kerkesave | | |
| **Total** | **153,801** | |

Ne kete post te bilancit paraqitet paradhenie gjate vitit si dhe disa pardhenie punonjesve dhe per te paguara per porosi.

## 5. Inventaret

Gjendja e inventareve gjate periudhes 1 Janar deri me 31 Dhjetor 2018 paraqitet si me poshte:

| | Gjendja inventareve ne fillim te periudhes | Blerjet e periudhes | Gjendja e inventarve ne fund te periudhes | Kosto e shitjeve |
|---|---|---|---|---|
| Produkte te gatshme | - | | - | - |
| Prodhiem ne proces | - | | | - |
| Lende te para, te konsumueshme, pjese nderrimi. | - | - | - | - |
| Mallra per rishitje. | 81,138,431 | 170,706,557 | 84,263,378 | 167,581,610 |
| Nenprodukte dhe mbeturina. | | | | |
| **Subtotal** | **81,138,431** | **170,706,557** | **84,263,378** | **167,581,610** |
| Zhvleresime per inventaret e vjeteruar. | | | | |
| **Total** | **81,138,431** | **170,706,557** | **84,263,378** | **167,581,610** |

Inventaret jane njohur me koston e tyre te blerjes. Per te percaktuar koston e tyre eshte perdorur metoda e mesatares se ponderuar. Shoqeria eshte treguar e kujdeshme duke vleresuar inventaret me vleren me te ulet midis kostos dhe vleres neto te realizueshme dhe nuk ka konstatuar perkeqsim per te bere zhvleresimin e tyre.

## 7. Aktivet Afatgjata Materiale

Me 31 Dhjetor 2019 dhe 31 Dhjetor 2018 Aktivet Afatgjata Materiale paraqiten si me poshte:

| | Ndertime | Makineri | Mjete transporti | Mobilje paisje zyre | Pajisje informatike | TOTAL |
|---|---|---|---|---|---|---|
| **AAM Vlera Bruto** | | | | | | |
| Gjendje 01.01.2019 | **1,001,816** | **7,899,215** | **13,010,069** | **10,518,936** | **10,046,349** | **42,476,386** |
| Shtesa | - | | 3,988,223 | 1,525,625 | 625,261 | 6,139,109 |
| Pakesime | - | | | - | - | |
| Riklasifikime nga CIP | - | - | - | - | - | - |
| Tjeter | - | - | - | - | - | - |
| **Gjendje 31.12.2019** | **1,001,816** | **7,899,215** | **16,998,292** | **12,044,561** | **10,671,610** | **48,615,495** |
| | | | | | | |
| **ZHVLERESIM I AKUMULUAR** | | | | | | |
| **Gjendje 01.01.2019** | **590,572** | **7,311,859** | **8,322,826** | **6,968,493** | **7,206,376** | **30,400,129** |
| Shtesa | 20,562 | 117,471 | 1,070,389 | 842,861 | 766,428 | 2,817,712 |
| Pakesime | | | (2,576,935) | - | - | - |
| Riklasifikime nga CIP | - | - | - | - | - | - |
| Tjeter | - | - | - | - | - | - |
| **Gjendje 31.12.2019** | **611,134** | **7,429,332** | **11,970,151** | **7,811,355** | **7,972,804** | **30,400,127** |
| | | | | | | |
| **Vlera e mbetur neto** | | | | | | |
| **Gjendje 01.01.2019** | **411,244** | **587,356** | **4,687,243** | **3,550,443** | **2,839,974** | **12,076,260** |
| **Gjendje 31.12.2019** | **390,682** | **469,884** | **5,028,141** | **4,233,206** | **2,698,806** | **12,820,719** |

AAM jane njohur ne kontabilitet me koston e blerjese tyre dhe shoqeria ka zgjedhur si politike te saj kontabile modelin e kostos ku cdo element i AAM paraqitet me kosto minus amortizimin e akumuluar. Ajo nuk ka akumuluar as nje humbje nga zhvleresimi. Normat e amorizimit te zbatuara jane ato te percaktuara ne Ligjin nr.8438, date 28.12.1998 "Per tatimin mbi te ardhurat"

## 8. Furnitore

Me 31 Dhjetor 2019 dhe 31 Dhjetor 2018 gjendja e furnitoreve te Kompanise paraqitet si me poshte :

| | 31/12/2019 | 31/12/2018 |
|---|---|---|
| Furnitore te pagueshem | 89,579,993 | 90,470,884 |
| Furnitore (Pale te treta) | | |
| | | |
| **Total** | **89,579,993** | **90,470,884** |

Furitoret ne monedha te huaja jane vleresuar me kursin e fundit te vitit te shpallur nga Banka e Shqiperise me daten 31.12.2019 , ata jane analitik dhe te dokumentuar.

## 9. Te tjera te pagueshme

| | 31/12/2019 | 31/12/2018 |
|---|---|---|
| Paga dhe shperblime | | |
| Detyrime per sigurimet shoqerore | 756,642 | 693,550 |
| Shteti per tatim taksa | 1,569,096 | 1,751,935 |
| Kreditore te tjere | | |
| Ortake per detyrime te tjera | 7,813,519 | |
| **Total** | **10,139,257** | **2,445,485** |

Analiza e detajuar e detyrimeve ndaj shtetit paraqitet me poshte:

| **Analiza te shteti per tatim taksa** | **31/12/2019** | **31/12/2018** |
|---|---|---|
| Akcisa | | |
| Tatim mbi te ardhrat personale | 482,222 | 421,460 |
| TVSH-ja e pagueshme | 733,500 | 311,370 |
| Tatim ne burim | 68,270 | 178,558 |
| Tatim mbi fitimin | 237,134 | 791,798 |
| Tatim qera | 47,970 | 48,750 |
| **Total Shtesa** | **1,569,096** | **1,751,935** |

Detyrimet per sigurimet shoqerore jane likuiduar ne Janar te vitit 2020 po keshtu dhe tatimi mbi te ardhurat dhe TVSH-ja. Tatimi mbi fitimin likujdohet brenda dates 31 Mars 2020.

## 10. Huate dhe parapagimet

Me 31 Dhjetor 2019 dhe 31 Dhjetor 2018 gjendja e Huase dhe parapagimet paraqitet si me poshte:

| | 31/12/2019 | 31/12/2018 |
|---|---|---|
| Hua Afat Shkurter | 1,500,000 | 1,500,000 |
| | | |
| **Total** | **1,500,000** | **1,500,000** |

Huaja afat shkurter eshte kreditimi qe eshte marre me Master Card per nevojat e biznesit.

## 11. Kapitali

Me 31 Dhjetor 2019 dhe 31 Dhjetor 2018 situata e kapitalit paraqitet si me poshte:

| | 31/12/2019 | 31/12/2018 |
|---|---|---|
| Kapitali i autorizuar, i leshuar & Plotesisht i paguar. | 1,200,000 | 1,200,000 |
| Vlera nominale e çdo pjese dhe e çdo aksioni | 1,000 | 1,000 |

| *Emri i Aksionerit (Ortakut)* | *Numri i pjeseve* | *Perqindja e pjeseve* | *Vlera e pjeseve* |
|---|---|---|---|
| Teodor Misha | 1 | 80% | 960,000 |
| Christopher Hadzopoulos | 1 | 20% | 240,0000 |
| **Total** | **2** | **100%** | **1,200,000** |

Kapitali i shoqerise i perket ortakeve te mesiperm.

## 12. Rezervat

Me 31 Dhjetor 2019 dhe 31 Dhjetor 2018 Rezervat paraqiten si me poshte:

| | 31/12/2019 | 31/12/2018 |
|---|---|---|
| Rezerva ligjore | 120,000 | 120,000 |
| Rezerva te tjera | 0 | 0 |
| **Total** | **120,000** | **120,000** |

Nuk ka ndryshime tek rezervat e shoqerise.

## 13. Tatim Fitimi

Me 31 Dhjetor 2019 dhe 31 Dhjetor 2018, tatim fitimi paraqitet si me poshte:

| | 31/12/2019 | 31/12/2018 |
|---|---|---|
| Tatim fitimi llogaritur | 1,924,585 | 1,889,792 |
| Tatim fitimi paguar gjate vitit | (2,617,456) | (698,771) |
| Plus / Minus | 455,737 | (2,121,026) |
| **Tatimi mbi fitimin ne Bilanc** | **(237,134)** | **(930,005)** |
| Fitimi ushtrimit | 12,819,947 | 12,081,016 |
| **Plus :** Shpenzime te panjohura | | |
| Shpenzime te tjera | | 485,189 |
| Taksa & gjoba | 10,622 | 32,406 |
| **Total** | **10,622** | **517,595** |
| **Fitimi para tatimit** | **12,830,569** | **12,598,611** |
| **Minus :** Te ardhura jo te taksueshme | | |
| Humbje taksash te viteve te meparshem | | |
| **Total** | | |
| **Perfitime te taksueshem** | **12,830,569** | **12,589,611** |
| Norma e tatimit mbi fitimin | 15% | 15% |
| **Tatim fitimi per vitin** | **1,924,585** | **1,889,792** |
| **FITIMI NETO NE BILANC** | **10,895,362** | **10,191,224** |

### 13. Tatim Fitimi (vazhdon)

Ne llogaritjen e tatim fitimit jane zbritur shpenzimet e panjohura per gjobat dhe te tjera te pa dokumentuara. Norma e tatim fitimit per vitin 2019 eshte 15% (2018;15%). Ne vitin 2019 shoqeria del me pagese ne vleren 237 134 leke. Gjate vitit 2019 kemi nuk kemi kontroll te kryer nga organet tatimore.

### 15. Te ardhura te shtyra

| | 31/12/2019 | 31/12/2018 |
|---|---|---|
| Te ardhra te shtyra | - | - |
| **Totali** | - | - |

Gjate vitit 2019 nuk ka pasur te ardhra te shtyra.

### 1. Te Ardhura dhe Shpenzime

Me 31 Dhjetor 2018 dhe 31 Dhjetor 2017 te ardhurat dhe shpenzimet e Shoqerise paraqiten si me poshte:

**a. Shitjet**

| | 01/01/2019 - 31/12/2019 | 01/01/2018 - 31/12/2018 |
|---|---|---|
| Shitje produktesh | - | - |
| Shitje produkte te ndermjetme | - | - |
| Shitje e nenprodukteve | - | - |
| Shitje e punimeve dhe sherbimeve | | |
| Shitje mallrash | 279,636,045 | 277,371,109 |
| Te ardhura nga shitje te tjera | 3,354,253 | 3,686,305 |
| **Totali i: a) shitjeve** | **282,990,298** | **281,057,414** |

***b. Te ardhura te tjera nga veprimtaria e shfrytezimit***

| | 01/01/2019-31/12/2019 | 01/01/2018 - 31/12/2018 |
|---|---|---|
| Prodhimi i aktiveve afatgjata materiale | - | - |
| Te ardhura te tjera | - | - |
| Te ardhrura nga rivleresimi/shitja e aktiveve | - | |
| **Totali i: b) te ardhurave te tjera** | - | |

**c) Kosto te Shitjes**

| | 01/01/2019-31/12/2019 | 01/01/2018 - 31/12/2018 |
|---|---|---|
| Kosto e mallrave te shitur | 167,581,610 | 158,742,098 |
| **Total i: c) Kosto te Shitjes** | **167,581,610** | **158,742,098** |